

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Zbulohet skema/ Meteo dhe Ulza dyshohen për marrëveshje të fshehtë në tenderin 2.8 mln euro - REPORT.AL
ADRESA	https://report.al/zbulohet-skema-meteo-dhe-ulza-dyshohen-per-marreveshje-te-fshehte-ne-tenderin-2-8-mln-euro/
BURIMI	report.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 12:07:13 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 12:03:34 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9e6b3e6e70bbe35bc603e46102607050ae32305df1a474bb57416d5e2cc21afc
TEKSTI	7f5144c6a5449b5f835d7d1bab35b403398ac71740df349ed67b4c158253b2d1
PAMJA	5c60baa82b9c350cde0d214e0020ee4d2d393296b45a99ab0a94f6ff3221ffc2

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b1721077fd3ce8bfb261a62885b9c87c2c9f5012b952353b890bbaea2721bbd4
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c459fbdf88f453b54a4131a2c6b72ae8533f09b2deef09d60e250bd91e1b553d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b1721077fd3ce8bfb261a62885b9c87c2c9f5012b952353b890bbaea2721bbd4>

PAMJA E FAQES


Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Home Aktualitet

Zbulohet skema/ Meteo dhe Ulza dyshohen për marrëveshje të fshehtë në tenderin 2.8 mln euro

by editor — September 17, 2026 in Aktualitet, Kronikë, Kryesore

0
SHARES

Share on Facebook

X Share on Twitter

Një tender i Operatorit të Blerjeve të Përqendruara për mbrojtjen nga gjërryerjet të Lumit Drin në Shkodër, hedh indicie të forta për koluzion në tender. Sipas dokumentave të publikuara në Agjencinë e Prokurimeve Publike, në garën me vlerë limit 2.8 milionë euro janë paraqitur 12 oferta.

OBP skualifikoi si anomalisht të ulëta tre ofertat me çmimin më të mirë dhe shpalli fitues bashkimin e kompanive Ulza dhe G.P.G.

Por tenderi zbulon një ngjarje me probabilitet statistikor të pamundur. Oferta fituese e Ulzës dhe G.P.G është e njëjtë në vlerë me atë të bashkimit të shoqërive Shëndelli dhe Meteo.

4.BOE "Shëndelli" shpk

Emri i plotë i shoqërisë

K07924803N

Numri i NIPT-t

&

"METEO".SH.p.k

Emri i plotë i shoqërisë

L26310801C

Numri i NIPT-t

Vlera: 177,238,950 (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë milionë e dyqind e tridhjetë e tetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, total pikë të marra 377.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat

(Emrat e nënkontraktorëve, Nipt-et, % e nënkontraktimit)

5. B.O.E "G.P.G. COMPANY" sh.p.k

Emri i plotë i shoqërisë

J64324443V

Numri i NIPT-t

&

ULZA

Emri i plotë i shoqërisë

J67902928O

Numri i NIPT-t

Vlera: 177,238,950 (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë milionë e dyqind e tridhjetë e tetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, total pikë të marra 450.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

TË FUNDIT

Zbulohet skema/ Meteo dhe Ulza dyshohen për marrëveshje të fshehtë në tenderin 2.8 mln euro

SEPTEMBER 17, 2026

Gjykata e Tiranës liron aktivistët e arrestuar gjatë tubimit të së hënës

SEPTEMBER 17, 2026

Botoxi kontrabandë fryhet për "Gremi Wellness" dhe shfryhet për "Keit", si u mbyll dosja për doktorin e VIP-ave, Skerdi Faria!

SEPTEMBER 17, 2026

"O e sjell, o jap dorëheqjen"! Ministria e re sfidon Kuvendin me premtimin për PET-Scan në Onkologjik

SEPTEMBER 17, 2026

Tensione në protestë, protestuesit përmbysin kazanët e mbeturinave në rrugë!

SEPTEMBER 17, 2026

Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së/ Deputetja: Më penguan të flas në Kuvend, shteti shqiptar ka heshtur

SEPTEMBER 17, 2026

"Urime për look-un e ri"! Deputeti ironizon Zegjine Çaushin, ajo 'shpërthen': Psikopat

SEPTEMBER 17, 2026

Tensionet në protestë/ Protestuesit heqin gardhin metalik para Ministrisë së Brendshme

SEPTEMBER 17, 2026

Shqipëria me ujë "me turne"/ Vetëm Lezha arrin 24 orë, Kamza mbetet në 4 orë

SEPTEMBER 17, 2026

Përshkallëzon protesta jashtë Kuvendit/ Qytetarët godasin me vezë efektivët e policisë, arrestohet një person

SEPTEMBER 17, 2026

Siç tregohet nga foto të dy bashkimet e kompanive kanë ofruar çmimin 177 milionë 238 mijë e 950 lekë. Statistikisht kjo ngjarje ka një probabilitet ndodhje 1 në 243 milionë, po të merret parasysh se kompanitë kanë pasur mundësi të bëjnë oferta nga vlera 1 deri në vlerën e fondit limit, 243 milionë lekë.

Dyshimi i madh është se Ulza dhe Meteo luajnë të kordinuara për të rrethuar tenderat publikë me marrëveshje të ndaluara nga ligji i Konkurrencës.

Ky dyshim përforcohet edhe nga një fakt tjetër. Vetëm pak ditë më parë Ulza dhe Meteo ishin bashkë në joint Venture në një tjetër tender. Bëhet fjalë për rikonstruksimin e Spitalit të Matit, një tender me vlerë 3.7 milionë euro.

Në këtë procedurë Ulza, Meteo dhe ASI-2A ofertuan së bashku në Joint Venture me vlerën 3 milionë euro, por dështuan pasi gara u fitua nga një kompani që ishte ofertë 600 mijë euro më të ulët. Megjithatë Ulza dhe Meteo po kërkojnë ta përmbysin tenderin në KPP, pavarsisht se janë 600 mijë euro më shtrenjtë se kompania e përzgjedhur fituese.

Ulza është kompania e skandalit të Unazës së Burrelit, e cila u shemb dy javë pas ndërtimit. Kjo kompani zotërohet nga një ish deputet demokristian i quajtur Ndue Shpani së bashku me vëllain e tij, Nikolin Shpani. Ulza është e fortë veçanërisht në zonën e Matit dhe mbështetet fuqishëm nga Agron Malaj.

Ndue Shpani dhe Ami Kozeli

Meteo nga ana tjetër është një kompani me bazë në Elbasan e zotëruar nga Eral Myftaraj. Dy muaj më parë, zoti Myftaraj u thir në SPAK për një tender 1 milionë euro në bashkinë e Tiranës.

Eral Myftaraj ne SPAK

Pra dy biznesmenë me rekorde jo për t'u patur zili, të cilët tashmë luajnë në grup për të rrethuar tenderat publikë.

Koluzioni ne tenderat publikë është një fenomen manipulimi i pastër i tenderave me dëm të madh në kurriz të qytetarëve. Por pavarësisht kësaj, deri më tani Autoriteti i Konkurrencës nuk ka goditur asnjë rast.

Tenderi i gërryerjeve në lumin Drin është një indicie më shumë se flagrante, që Shqipëria më në fund të godasë biznesmenët të cilët bashkëpunojnë për të manipuluar tenderat publikë./ [kapitali.al](#)

Previous Post

Gjykata e Tiranës liron aktivistët e arrestuar gjatë tubimit të së hënës



editor

report.al


REPORT.AL

Portali report.al është një media online e pavarur që sjell lajme, analiza dhe informacione të sakta në kohë reale. Me fokus tek transparenca dhe vërtetësia, portali synon t'u ofrojë lexuesve shqiptarë një burim të besueshëm lajmesh nga politika, ekonomia, shoqëria dhe ngjarjet ndërkombëtare.

RUBRIKAT

Aktualitet
OP-ED
Politike
Rajon
Showbiz
Sociale
Shëndet
Sport

MË TË KLIKUARAT



E rëndë, elektrikisti që humbi jetën gjatë punës në Belsh nuk kishte asnjë mjet mbrojtës

01

0 SHARES



Parandalohet ngjarja e rëndë në Rogozhinë, arrestohet i riu që kanosi me kallashnikov 35-vjeçarin

0 SHARES



Skandali/ Policia rrugore shoqëron kamionët e Alesios në orarin e ndalimit të qarkullimit

0 SHARES

© 2025 REPORT.AL

Aktualitet / OP-ED / Politike / Rajon / Showbiz / Sociale / Shëndet / Sport

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.